

L I G J
Nr.8780, datë 3.5.2001

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN 8609, DATË 8.5.2000,
“KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Në ligjin 8609, datë 8.5.2000 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2, pas pikës 33 shtohet pika 34 me këtë përmbajtje:

“34. “Rezultat përfundimtar i zgjedhjeve” është rezultati i shpallur nga KQZ-ja dhe që përfshin:

a) rezultatin e votimit për kandidatët për deputetë, kryetarë bashkie dhe komune, të cilët janë zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë në njësitë zgjedhore përkatëse;

b) numrin e vendeve të fituara nga çdo parti politike ose koalicion pas llogaritjeve të parashikuara në nenet 66 dhe 75 të këtij Kodi;

c) rezultatin e votimit në referendum, sipas dispozitave të pjesës së tetë të këtij Kodi.”

Neni 2

Neni 34 ndryshohet si vijon:

“Anëtarët e KZZ-së shkarkohen nga KQZ-ja kur nuk përmbushin detyrat e parashikuara në këtë Kod dhe në aktet normative të KQZ-së, si dhe për të njëjtat shkaqe që çojnë në shkarkimin e anëtarëve të KQZ-së.”

Neni 3

Neni 40 ndryshohet si vijon:

“Anëtarët e KZQV-së shkarkohen nga KQZ-ja kur nuk përmbushin detyrat e parashikuara në këtë Kod dhe në aktet normative të KQZ-së, si dhe për të njëjtat shkaqe që çojnë në shkarkimin e anëtarëve të KQZ-së.”

Neni 4

Në nenin 56, pas paragrafit të parë shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Kur zgjedhësi vëren se nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të zonës zgjedhore të vendqëndrimit të tij, pas kalimit të afatit të përcaktuar në paragrafin e parë të këtij neni, ai mund t’i drejtohet gjykatës deri në 24 orë përpara datës së zgjedhjeve, për të kërkuar regjistrimin e tij në këtë listë, për të ushtruar të drejtën e votës në datën e caktuar për zgjedhje.

Zgjedhësi është i detyruar t’i paraqesë gjykatës çertifikatën e lindjes së gjendjes civile, vërtetimin e njësisë përkatëse të organit të pushtetit vendor ku ai ka vendqëndrimin e tij dhe vërtetimin nga KZZ-ja ose sipas rastit nga KZQV-ja, të cilat deklarojnë se zgjedhësi nuk është i regjistruar në listën e zgjedhësve të zonës, në të cilat zhvillohen zgjedhjet.”

Neni 5

Në pikën 1 të nenit 80, në fjalinë e parë, në vend të fjalës “KQZ-së” vihet fjala “KQV-së”.

Neni 6

Pika 3 e nenit 87 ndryshohet si vijon:

“Për zgjedhjet për Kuvend zgjedhësi voton në dy fletë të veçanta me ngjyra të ndryshme, një për kandidatët që konkurrojnë drejtpërdrejtë në zonë dhe tjetra për partitë politike dhe koalicionet që konkurrojnë në ato zgjedhje. Fleta e votimit për subjektet zgjedhore është e njëjtë për të gjitha zonat e zgjedhjeve.”

Neni 7

Në nenin 97, pas pikës 5 shtohen pikat 6 dhe 7 me këtë përmbajtje:

“6. Pasi zgjedhësi merr fletën e votimit, ai timbroset në dorën e majtë me një lëndë të posaçme nga një anëtar i KQV-së, me qëllim shmangien e votimit më shumë se një herë.

7. Kur përpara KQV-së paraqitet një zgjedhës, i cili nuk është i regjistruar në listat zgjedhore përfundimtare, por është i pajisur me një vendim gjyqate, e cila i jep të drejtë të votojë në atë zonë votimi, atëherë komisioni e evidenton zgjedhësin me një numër dhe regjistër të veçantë.

Procedurat dhe mënyrat e regjistrimit të këtyre zgjedhësve përcaktohen me udhëzim të KQZ-së.”

Neni 8

Neni 155 ndryshohet si vijon:

“Për zgjedhjet vendore të vitit 2000 dhe për zgjedhjet e përgjithshme 2001, zgjedhësit që nuk janë pajisur me kartën e zgjedhësit mund të votojnë me një dokument identiteti me fotografi të lëshuar nga zyrat e gjendjes civile, sipas udhëzimeve të nxjerra nga KQZ-ja.”

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.3002, datë 10.5.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Rexhep Meidani.**

**KRYETARI
Skënder Gjinushi**